



REPUBLIKA E SHQIPËRIË
MINISTRIA E KULTURËS

**EKSPOZITA NDËRKOMBËTARE E ARTIT ONUFRI.
EDICIONI XXIII AU FIL DU TEMPS - Kujtesë kolektive,
kujtime personale 20 Dhjetor 2017 - 30 Janar 2018
2017-12-19 14:52:00**



Galeria Kombëtare e Arteve më datë 20 Dhjetor, ora 18:00, ka kënaqësinë të hapë për publikun Edicionin e 23-të të Ekspozitës Ndërkombëtare "Onufri". Kuruar nga Gaetano Centrone, ekspozita titullohet "AU FIL DU TEMPS - Kujtesë kolektive, kujtime personale". Ekspozita ofron një itinerar ekspozues që zhvillohet në dhomat dhe ambientet e Galerisë Kombëtare të Arteve në Tiranë. Janë dhjetë artistë pjesëmarrës, që vijnë nga gjashtë vende; të gjithë të

lindur në vitet '70 dhe '80 dhe me një cv të pasur ndërkombëtare: Zeni Ballazhi, Adi Haxhiaj, Koja, Perino & Vele, Leonard Qylafi, Calixto Ramírez, Jelena Tomasevic, Vangjush Vellahu, Alketa Xhafa Mripa, Fani Zguro.

Galeria Kombëtare e Arteve më datë 20 Dhjetor, ora 18:00, ka kënaqësinë të hapë për publikun Edicionin e 23-të të Ekspozitës Ndërkombëtare "Onufri".

Kuruar nga Gaetano Centrone, ekspozita titullohet "AU FIL DU TEMPS - Kujtesë kolektive, kujtime personale"

Ekspozita ofron një itinerar ekspozues që zhvillohet në dhomat dhe ambientet e Galerisë Kombëtare të Arteve në Tiranë. Janë dhjetë artistë pjesëmarrës, që vijnë nga gjashtë vende; të gjithë të lindur në vitet '70 dhe '80 dhe me një cv të pasur ndërkombëtare: Zeni Ballazhi, Adi Haxhiaj, Koja, Perino & Vele, Leonard Qylafi, Calixto Ramírez, Jelena Tomasevic, Vangjush Vellahu, Alketa Xhafa Mripa, Fani Zguro.

Kuratori Centrone përpiket, me aq sa është e mundur, për të gjetur një emërues të përbashkët që bashkon përvojën e shumicës mes artistëve shqiptarë, sepse filloi prej tyre në këtë hulumtim që dëshiron të jetë aktual dhe ndërkombëtar. Pas shumë studimesh ai doli në konkluzionin se Historia mbizotëron në punën e tyre. Por kuratori nuk ka qëllim të ndërtojë një ekspozitë politike (kjo nuk është në planet e tij) duke qenë se ka një dallim të madh mes elementit kulturor dhe atij socio-politik. Në këtë pikë faktori kohë bëhet një element qendror. Mënyra se si koha gërren në kokat tona dhe çfarë mbetet e konsiderohet ex post. Dallimi midis kujtesës kolektive dhe kujtesës personale është shumë i paqartë, më shumë se sa mund të mendohet. Dhe po ashtu dallimi mes njëjësit dhe shumësit është më kompleks se sa mund të mendohet. Ekziston një apo shumë kujtime kolektive? Dhe kush i formon ato? Dhe sa kujtime personale preken nga ngjarjet e historisë? Është e panevojshme të mohohet se në këtë pjesë të botës ngjarjet historike kanë hyrë shumë në jetën e popujve. Për zgjedhjen e titullit ne kërkuam një shprehje të mrekullueshme të gjuhës frënge: au fil du temps. Në italisht, për shembull, mund të përkthehet me kalimin e kohës, por fjalë për fjalë ka bukurinë e saj në versionin origjinal: në fije të kohës. Një fije që ngjitet Historinë me histori personale, duke shtyrë nga lart me zërat e ndryshëm polifonikë të një tregimi. Aktualiteti i së tashmes, historia në sfond.

Onufri Prize
23rd International Art Exhibition ?AU FIL DU TEMPS –
Collective memory, personal memories
20 December 2017 – 30 January 2018

Art curator: Gaetano Centrone

Artists: Zeni Ballazhi, Adi Haxhijaj, Koja, Perino & Vele, Leonard Qylafi, Calixto Ramirez, Jelena Tomasevic, Vangjush Vellahu, Alketa Xhafa Mripa, Fani Zguro.?

The exhibition offers an itinerary that takes place in the rooms of the National Gallery of Arts of Tirana. There are ten participating artists from six different countries; all of them were born in the 70's and in the 80's and have a noteworthy international curriculum. The point of view of the curator Centrone was to find – however it is possible – a denominator which combines the experience of the majority among the Albanian artists, because he started from them during his research, with the intention of being actual and international. As a result of years of study, he has observed the prevalence of the history in their works. However he has no intention of creating a political exhibition, that is not the curator's aim, there is a great difference between the cultural element and the socio-political one. Therefore the concept of time becomes a key element. The way how time incises our mind and what remains as ex post. The difference between collective memory and personal memories is very light, more than we would think. Also the difference between singular and plural form is more complex than we would think. Is there only one or are there more collective memories? And who creates them? And how much personal memories are influenced by historical events? It is useless to deny the fact that in this part of the world historical events have heavily affected the populations' past.

For the title, the curator has sought help from a marvellous expression from the French language: au fil du temps. In English, for example, it could be translated as over time, but the real beauty can be found actually in the original meaning: on the thread of time. A thread which waves together history and personal histories, pushing from above with the different polyphonic voices of a story. The newness of the present, the history in the background.